



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:016657

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05389609

APS.nr.45/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani- Kryetar, Burim Ademi dhe Bashkim Hyseni anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Gazmend Ramadani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S. B. për shkak të veprave penale Marrje e ryshfetit nga neni 421 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (më tutje KPRK) dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S. B. avokat B. B., të paraqitura ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PS.nr.10/20 i datës 28.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 15.12.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** ankesa e mbrojtësit të pandehurit S. B. avokat B. B., për vendimin mbi dënimin me burgim dhe me gjobë, ashtu që **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti Special PS.nr. 10/2020 i datës 28.04.2023, vetëm për sa i përket dënimit me burgim dhe dënimit me gjobë, ashtu që kjo gjykatë të pandehurit S. B. për veprën penale të Marrjes së ryshfetit nga neni 421 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, për të cilën është shpallur fajtor, i shqipton dënim

me burgim në kohëzgjatje prej 2 viteve dhe dënim me gjobë në shumën prej 3.000 euro, ndërsa për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 për të cilën është shpallur fajtor i shqipton dënim me gjobë në shumën prej 500 euro. Në mbështetje të nenit 76 i shqipton dënim UNIK me Gjobë në shumën prej 3.500 euro. Pjesa tjetër e aktgjykimit për dënimin plotësues dhe konfiskimin e armës mbetet e pandryshuar. Ankesa ne e mbrojtjes ne bazat tjera refuzohet si e pabazuar.

- II. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Speciale kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti Special PS.nr. 10/2020 i datës 28.04.2023, lidhur me sanksionin penal.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë –Departamenti Special, ka marrë aktgjykimin PS.nr.10/2020 i datës 28.04.2023, me të cilin të akuzuarin S. B., e ka shpallur fajtor për shkak të veprave penale Marrje e ryshfetit nga neni 421 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, për të cilën vepër e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashhtë) muaj, në të cilin dënim llogaritet dhe koha e kaluar në paraburgim nga data 19.09.2019 deri më 13.12.2019 si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 14.12.2019 deri më datën 23.02.2020, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 4000 (katërmijë) euro, ndërsa për veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro, ashtu që e ka gjykuar me dënim unik me gjobë në shumë prej gjithsej 5000 (pesëmijë) euro, të cilin i akuzuari është i detyruar ta paguaj në afat prej 1 (një) muaji nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ndërsa, si dënim plotësues i ka shqiptuar Ndalimin e ushtrimit të funksioneve në Administratën Publike ose në shërbim publik në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të fillojë të ekzekutohet pas mbajtjes së dënimit me burgim të shqiptuar me aktgjykim. Ndaj të akuzuarit konfiskohet arma e tipit ‘Zaza Mini’ e kalibrit 8 mm, me numër serik:T..., së bashku me 10 fishekë, si objekt i kryerjes së veprës penale.

Po ashtu, gjykata ka vendosur që të akuzuarit S. B., pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkallës së parë i kthehet shuma e parave prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro, për shkak se nuk ka

bazë ligjore për konfiskimin e tyre, ashtu që obligohet Agjencia për Sekuestrimin e Pasurisë së Konfiskuar në Prishtinë që të njëjtën shumë të sekuestruar të ia dorëzojë të akuzuarit.

Është detyruar i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 300 (treqind) euro si dhe në emër të programit për kompensim të viktimave të krimit shumë prej 100 (njëqind) euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë:

- Prokuroria Speciale, për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale (neni 387 par. 1 të KPP-së), me propozim që të aprovohet ankesa, të ndryshohet aktgjykimi, dhe të shqiptohet dënim më i lartë nga ai që është shqiptuar, dënimi për të akuzuarin të jetë në bazë të ligjit dhe në proporcion me peshën e veprave penale të kryera, nga i akuzuari.
- Kurse, përgjigje në ankesën e Prokurorisë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit S. B. avokati B. B., me propozim që ankesa e mbrojtjes të aprovohet, të refuzohet ankesa e prokurorisë, të ndryshohet aktgjykimi në atë mënyrë që i akuzuari të lirohet, ose të ndryshohet dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet sanksion penal më i butë, i konvertuar në dënim me gjobë, ose të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, kurse ankesa e prokurorisë në këtë rast do të jetë jo lëndore.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor po ashtu ka paraqitur ankesë:

- Mbrojtësi i të akuzuarit S. B. avokati B. B. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale (neni 383 par. 1 nën par. 1.1 i KPP, lidhur me nenin 384 të KPP), shkeljes së ligjit penal në dëm të pandehurit (neni 383 par. 1 nën par. 1.2 i KPP, lidhur me nenin 385 të KPP), vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 383 par. 1 nën par. 1.3 i KPP, lidhur me nenin 386 të KPP) dhe vendimit lidhur me sanksionin penal (neni 383 par. 1 nën par. 1.4 i KPP, lidhur me nenin 387 të KPP), me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa, të konstatojë se aktgjykimi i atakuar përmban shkeljet e pretenduara, të ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe të lirojë nga akuza të akuzuarin S. B. (neni 398 par. 1 nën par. 1.4 i KPPRK-së). Apo në alternativë kjo palë propozon të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe të zbutet sanksioni penal ndaj të akuzuarit ose Gjykata e Apelit të anulojë aktgjykimin e atakuar dhe të kthejë çështjen në rigjykim.

- Përgjigje në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit S. B. avokatit B. B., ka parashtruar Prokuroria Speciale, me të cilin propozon që të refuzohet ankesa e mbrojtjes, kurse të aprovohet ajo e prokurorisë dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim më i lartë nga sa i është shqiptuar.

Prokuroria e Apelit, ka paraqitur parashtresën me shkrim PPA/I.nr.549/23 të datës 20.10.2023, me propozim që të aprovohet ankesa e prokurorisë, ashtu që aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më të lartë, sesa me aktgjykimin e ankimuar, si dhe përgjigja e prokurorisë, kurse të refuzohen ankesa dhe përgjigja në ankesën e PSRK-së, të parashtruara nga mbrojtësi i të akuzuarit S. B., avokati B. B., si të pabazuara.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit të datës 15.12.2023, ka njoftuar prokurorin e apelit, mbrojtësin e të pandehurit dhe të pandehurin, përkundër se në mënyrë të rregullt është njoftuar prokurori i Apelit i njëjti nuk ka prezantuar në seancën e kolegjit dhe nuk ka arsyetuar mungese, ndërsa në seance kanë prezantuar i pandehuri S. B. dhe mbrojtësi i tij av. B. B..

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të prokurorisë, mbrojtësit të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit është pjesërisht e bazuar vetëm për sa i përket dënimit ndërsa është e pabazuar për bazat tjera, ndërsa ankesa e prokurorisë është e pabazuar.

Pretendimet ankimore

Ankesa e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës

Në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, thekson se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit nuk e ka caktuar drejtë dënimin. Dënimi i shqiptuar në këtë rast, sipas Prokurorisë, nuk i arrin qëllimet e dënimit të parapara me nenin 38 të KPRK-së. Dënimi i shqiptuar për veprë penale kundër detyrës zyrtare, është i ulët për tu arritur qëllimi i dënimit, dhe përbën sjellje të kundërligjshme e drejtuar kundër funksionimi të rregullt të shërbimeve publike, të kryera nga personat zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose lidhur me kryerjen e detyrës zyrtare, e cila formë bie në kategorinë e kriminalitetit me shkallë të lartë rreziku për shoqërinë. Me anë të kësaj ankese, Prokuroria thirret në nenin 70 të KPRK-së, ku përcaktohet se me rastin e matjes së dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në

rrethanat e mëposhtme rënduese, e që në rastin konkret, sipas Prokurorisë, janë po ashtu prezentë: shkalla e lartë e dashjes, keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe motivi për kryerjen e veprës penale. Sipas ankesës, gjykata rrethanat rënduese i ka konsideruar, mirëpo përkundër tyre ka shqiptuar një dënim tejet të ulët, marrë parasysh dënueshmërinë që parashohin këto vepra penale, dhe faktin se forma më e rëndë e korrupsionit dhe ryshfetit nënkupton ryshfetin e gjyqtarëve, prokurorëve, zyrtarëve të policisë dhe pozitave të ndjeshme. Prokuroria gjithashtu shton se gjykata nuk ka marrë parasysh as mos kërkim faljen të akuzuarit dhe as mos pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, si rrethana rënduese me rastin e matjes së dënimit. Prokuroria konsideron, se nuk ka pasur rrethana lehtësuese, kurse qëndrimi korrekt i të pandehurit nuk mund të vlerësohet si e tillë, meqenëse është obligim i palëve në procedurë. Andaj, me shqiptimin e dënimeve të tilla nuk do të arrihet qëllimi i dënimit.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë, e paraqitur nga mbrojtësi i të akuzuarit S. B. avokati B. B.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë, ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit S. B. avokati B. B., e cila konsideron se ka pa bazueshmëri faktike dhe juridike të pretendimeve ankimore të prokurorisë. Sanksioni penal, mund t'i shqiptohet vetëm personit i cili ka kryer veprë penale, sipas kushteve të parapara me kodin penal dhe ligjet tjera të Kosovës, në bazë të së cilës janë paraparë veprat penale, sipas procedurës së zbatuar në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe të ligjshme para gjykatës kompetente. Procedura që i ka paraprirë marrjes së aktgjykimit, nuk është zhvilluar sipas kërkesave procedurale dhe materiale të imponuara nga legjislacioni, ndaj dhe sanksioni penal nuk mund të shqiptohet. Prokuroria në ankesë, elaboron elementet konstituive të veprës penale të marrjes së ryshfetit, që kinse nuk janë marrë parasysh si rrethana rënduese, e që sipas mbrojtjes cilësimi i elementeve konstituive të veprës penale si rrethana rënduese, përbën llogaritje të dyfishtë të rrethanave, për të cilat vlen ndalesa nga pika 3.4 e Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikën Ndëshkimore. Arsyetimi i dhënë nga prokuroria, përbën rrezik për shkeljen e parimit ne bis in idem gjatë dënimit, sepse kjo do të implikonte ndëshkimin e të njëjtit të pandehur dy herë për sjelljen e njëjtë, fillimisht për përgjegjësinë e tij individuale dhe pastaj duke përdorur të njëjtat fakte për ta ashpërsuar dënimin përfundimtar, duke i zbatuar ato si rrethanë rënduese. Pozita zyrtare e të akuzuarit, nuk përbën rrethanë rënduese, sepse veprën penale nga neni 421 i KPRK-së, mund ta kryejë vetëm personi zyrtar, i njëjti vlen edhe për motivin financiar, i cili është element i dashjes, ndërkohë që kjo përbën elementin subjektiv të veprës. Gjykata, ka dhënë arsye të paqarta, të pasakta dhe kontradiktore lidhur me pretendimet e

mbrojtjes, meqë mungon lidhja kauzale mes veprimit dhe pasojës. Sipas mbrojtjes, ekzistojnë rrethana subjektive që kushtëzojnë zbutjen e sanksionit penal, sikurse faktin se gjykata ka nënvlerësuar rrethanat posaçërisht lehtësuese që karakterizojnë personalitetin e të akuzuarit S., se ka vepruar nën provokimin e dëshmitarit F. Z., shkalla e ulët e dashjes, koha e kaluar nga pakti korruptiv prej të paktën 10 vjetesh, nuk ka precedent penal, i ka shërbyer gjyqësorit për gati 30 vjet, është në pension, gjendja e rëndë shëndetësore, gjendja e varfër ekonomike dhe se është mbajtës i familje. Edhe sanksioni plotësues, është i pazbatueshëm dhe i panevojshëm, sepse i akuzuari ka arritur moshën e pensionimit dhe nuk mund të ushtrojë funksione në kuadër të administratës publike ose shërbimit publik.

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S. B. avokati B. B.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit S. B. avokati B. B., pretendon se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nën par.2.1, 2.2, 2.6 dhe 2.7 të KPP-së, të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit gjyqësor të drejtë dhe të ligjshëm, për shkak se pika I e dispozitivit të aktgjykimit është e mangët në raport me përcaktimin e personit tjetër për të cilin është pranuar shuma prej 2000 euro, si dhe me kohën e dakordimit paraprak me dëshmitarin F. Z.. Gjykata, ka dhënë arsye të paqarta, të pasakta, kontradiktore, jo koherente, të pamjaftueshme lidhur me faktet vendimtare, në raport me përgjegjësinë penale të akuzuarin, sikurse me pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit. Gjykata, ka shqyrtuar dhe gjykuar çështjen pa zbatuar hetimet në drejtim të veprës penale të Marrjes së ryshfetit nga neni 421.1 i KPRK-së. Gjykata, ka mbështetur aktgjykimin mbi prova të papranueshme dhe ka tejkaluar fushëveprimin nga aktakuza, përkatësisht identiteti faktik nuk përputhet me atë faktik të aktakuzës. Gjykata, nuk ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarit, si dhe nuk ka vepruar në pajtim me nenin 360.2 të KPP-së, dhe është shkelur parimi in dubio pro reo. Mangësitë e pikës I të dispozitivit të aktgjykimit, mbrojtja konsideron se është e tillë në raport me përcaktimin e personit tjetër për të cilin është pranuar shuma prej 2000 euro, si dhe me kohën e dakordimit paraprak me dëshmitarin F. Z., çka përfshin aktgjykimin në shkelje esenciale nga neni 384.2, nën par.2.7 lidhur me nenin 369 ,4 dhe 364.1 nën par.1 të KPP-së. Në dispozitivin e aktgjykimit, mbetet i paidentifikuar personi me emrin “D.”, për çka mbrojtja konsideron se gjykata qëllimisht gjykon çështjen vetëm në një drejtim, duke përshkruar i akuzuari S. dhuratën e ka pranuar edhe për “D.”, ndërsa fare nuk bën konstatimin se kusht është D.. Mbetet e paqartë, po ashtu koha e saktë e dakordimit të supozuar mes të akuzuarit S. dhe dëshmitarit F. Z., e cila ka ndikim në përcaktimin e kohës së kryerjes së veprës penale. Gjykata, qëllimisht nuk e ka përcaktuar këtë

moment, për të kamufluar dhe shmangur parashkrimin e veprës penale. Ndjekja penale ndaj të akuzuarit në drejtim të veprës penale të marrjes së ryshfetit është e palejuar për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit relativ nga neni 106.1 nën par.1.4 të KPRK-së. Më tutje, pretendon se aktgjykimi përmban të meta procedurale, të pa kapërcueshme për shkak se është marrë në mungesë të fazës së hetimit në drejtim të po kësaj veprë penale. PSRK, asnjëherë nuk ka marrë aktvendim për fillim të hetimeve, apo zgjerim të hetimeve në drejtim të veprës penale Marrja e ryshfetit, çka ka sjellë për pasojë gjykimin e çështjes pa hetim, që bie ndesh me parimin akuzator, qëndrim i mbrojtjes i mbështetur nga mendimi Juridik i Gjykatës Supreme nr.218/15 të dt.10.07.2015. Aktgjykimi, përfshihet me shkelje esenciale nga neni 384.2 nën par.2.7 lidhur me nenin 369.7 të KPP-së, sepse janë dhënë arsye të paqarta, të pasakta dhe kontradiktore, është kamufluar përmbajtja e transkriptit të bisedës mes të akuzuarit S. dhe dëshmitarit F. Z. gjatë qëndrimit në restaurant T. në Pejë me datë 19.09.2019, janë dhënë arsye kamufluere mbi dijeninë e të akuzuarit lidhur me arsyen e takimit me dëshmitarit F. Z., janë dhënë arsye të paqarta, të pasakta, kontradiktore, lidhur me kohën e saktë të kryerjes së veprës penale, lidhja kauzale mes pranimi të shumës prej 2000 euro dhe pasojës, kërkesën e dhuratës, nxjerrjen e aktgjykimit të favorshëm për vëllain e dëshmitarit, parashkrimin e çështjes penale, refuzimet e propozimeve të mbrojtjes dhe nxitjen dhe provokimin e të akuzuarit S. nga dëshmitari F., të cilat mbrojtja i elaboron detajisht në ankesë. Sipas ankesës, janë kamufluar arsyet mbi refuzimin për dëgjimin e dëshmitarit S. B., dëshmitares V. H., refuzimin për dëgjimin e dëshmitarëve S. B.1 dhe V. K.. Po ashtu, gjykata ka dështuar që në arsyetimin e aktgjykimit të tregojë arsyet për refuzimin e propozimeve të mbrojtjes, siç e detyron obligimi procedural imperativ nga neni 369.7 i KPP-së. Po ashtu, është refuzuar kërkesa për kthimin e telefonit, apo sigurimin e bisedave të nxjerra nga telefoni i të akuzuarit S. B., por edhe janë refuzuar propozimet për administrimin e provave materiale. Gjithashtu, janë dhënë arsye kamufluere mbi nxitjen dhe provokimin e të akuzuarit S. B. nga dëshmitari F. Z.. Arsyetimi i gjykatës, kufizohet vetëm në dinamikën e ngjarjeve dhe nuk mbështetet mbi elementet që sipas praktikës së GJEDNJ-së, janë të detyrueshme për të përcaktuar nxitjen apo provokimin. Motivimi i dëshmitarit F. Z., për të denoncuar rrejshëm të akuzuarin S., në këmbim të dënimit të tij. Nga dëshmia e dëshmitarit e dhënë në polici është përgatitur dhe përpiluar nga zyrtarët policorë, është e pavërtetë në përmbajtjen e saj dhe është nënshkruar nga dëshmitari me bindjen se duke vepruar në këtë mënyrë do t'i shpëtonte ndjekjes penale për veprat e tij dhe do të shmangte vuajtjen e dënimit me burg, për çka mbrojtja i referohet detajisht edhe procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 23.09.2021, në pyetjet e drejtpërdrejta të PSRK-së. Sipas mbrojtjes, pazaret dhe negociatat kulmuan me arrestimin e të akuzuarit S. me datë 19.09.2019, ndërsa vetëm një ditë pas, me datë 20.09.2019, i dënuari u

shpërblye edhe me një tjetër shtyrje të ekzekutimit të dënimit me burgim, përmes nxjerrjes së aktvendimit ED.nr.40/2019 i datës 20.09.2019. Mbrojtja, i referohet të kaluarës kriminale të dëshmitarit F. Z., si dhe nxitjes së tij me rastin e simulimit të veprës penale, por edhe praktikës së GJEDNJ-së, lidhur me provokimin. Faktet vendimtare dhe rrethanat konkrete që ndikojnë në dimensionin kushtetues, në raport me të akuzuarin S. B., janë vërtetuar një sërë faktesh vendimtare dhe rrethana specifike që mbështesin nxitjen dhe provokimin nga ana e policisë: Motivi i dëshmitarit F. Z., për të këmbyer ekzekutimin e sanksionit penal të shqiptuar kundër tij me kurthimin e ndonjë gjyqtari, praktika e mëhershme e këtij dëshmitari për të kurthuar persona të tjerë në këmbim të ndaljes së ndjekjes penale kundër tij, apo mos ekzekutimit të sanksioneve penale, ka qenë policia ajo që ka thirrur dëshmitarin për të realizuar qëllimet e veta dhe nuk ka qenë dëshmitari ai që ka denoncuar rastin në polici, marrja e iniciativës për të kontaktuar të akuzuarin S. dhe insistimi i vazhdueshëm i dëshmitarit F. Z. që të takohej me të, mungesa e elementeve dhe provave paraprake objektive që bënin të besueshme përfshirjen e të akuzuarit në ndonjë aktivitet kriminal, se dëshmitari ka vepruar sipas udhëzimeve të hetuesve, dhe se gjatë bisedës së datës 19.09.2019, që i parapriu marrjes së parave, dëshmitari F. Z. i referohej në mënyrë abstrakte “D.”, që nuk ishte i pranishëm, por kurrë ndonjë marrëveshje paraprake me të akuzuarin S.. Më tutje, mbrojtja konsideron se gjykata ka dhënë arsye kamufluese mbi përgjegjësinë penale për posedim të kundërligjshëm të armës, meqë gjykata nuk ia fal besimin bashkëshortes Z. Th., bashkëshorte e të akuzuarit e cila kishte deklaruar se arma ishte e kumatit të saj, të akuzuarit S. B.1, vëllai i të akuzuari, i cili jeton në fshatin B. – Pejë, me familjen e tij dhe se armën e kishte lënë 2 -3 ditë para bastisjes, sepse po shkonte në Rozhajë. Dëshmitarja, po ashtu kishte theksuar se i akuzuari nuk ishte në dijeni për armën që vëllai e kishte lënë në shtëpinë e tij. Gjykata, nuk ia fal besimin dëshmisë së dëshmitares Z. Th., dhe shfrytëzimin e të drejtës për të mos inkriminuar veten, apo të afërmin e familjes, gjykata e përdor për të zhvlerësuar dëshminë e dëshmitares Z. Th., dhe përkeqësuar pozitën e të pandehurit S.. Për më tepër, moslajmërimi i posedimit të kundërligjshëm të armës përjashtohet shprehimisht nga formulimi i nenit 378.4 të KPRK-së, që përcakton veprën penale Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre. Gjykata, ka përkeqësuar pozitën e të akuzuarit S., përmes dhënies së arsyeve kamufluese dhe refuzimit të propozimit për të dëgjuar si dëshmitar S. B.1. Po ashtu, aktgjykimi përfshihet me shkelje esenciale nga neni 360.2 të KPP-së. meqenëse gjykata ka shtrembëruar përmbajtjen e transkriptit nga zbatimi i masave të fshehta me datë 19.09.2019, duke shkëputur nga konteksti bisedën mes të akuzuarit S. B. dhe dëshmitarit F. Z., ka dështuar në vlerësimin e dëshmitares Z. Th., në vlerësimin e dëshmisë së rreshterit V. Sh., dëshmitarit F. Z., dhe arbitrarisht ka përdorur kundër të akuzuarit, dëshmitë e dhëna nga ky dëshmitar në polici me datë 09.09.2019 dhe

23.09.2019. Më tutje, mbrojtja thekson se gjykata ka tejkaluar fushëveprimin e fakteve nga aktakuza, përkatësisht identiteti faktik i pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, nuk përkon me identitetin faktik të pikës I të dispozitivit të aktakuzës PPS.nr.52/2019 të datës 05.02.2020. Pika I e dispozitivit të aktgjykimit, përfshin si përfitues të dhuratës, edhe një tjetër person, të ashtëquajtur “D.”, të identifikuar si gjyqtari S. B., i cili fillimisht nuk ka qenë i precizuar në aktakuzën fillestare, dhe në raport me të cilin vet gjykata e shkallës së parë, ka penguar ballafaqimin gjatë shqyrtimit gjyqësor, përmes refuzimit të propozimit për ta thirrur dhe dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit. Më tutje, mbrojtja pretendon se aktgjykimi mbështetet në prova të papranueshme, sikurse kundërligjshmëria e CD e datës 19.09.2019, fotoincizimeve 030-V-2019, CD me video në automjet në trup, videos së kontrollit në trup dhe raportit të vëzhgimit të datës 19.09.2019. Provat e papranueshme në kuptim të nenit 97.1 të KPP-së, janë të kundërligjshme urdhëresat mbi bazën e të cilave janë siguruar, sikurse Urdhëresat PPPS.nr.165/19 e datës 11.9.2019, për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, meqenëse gjykata ka dështuar që të arsyetojë rrethanat specifike dhe individuale të rastit, arsye si dhe pse informacioni i siguruar përmes masës hetimore të fshehtë ka gjasë që të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe përse hetimi nuk mund të kryhej nëpërmjet mjeteve hetimore më pak invazive. Pretendimet e mbrojtjes, mbështeten edhe nga Qarkorja e Gjykatës Supreme të Kosovës n.12/2015 të datës 12.01.2015, por edhe neni 4 i Ligjit për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike nr.05/L-030. Më tutje, mbrojtja pretendon se procesverbali i kontrollit të personit dhe shtëpisë së lokaleve dhe pronës 2019 KE 372 i datës 19.09.2019, foto dokumentacioni nga vendi i bastisjes i kësaj date, dhe lista e armëve dhe municionit të konfiskuar 2019-DA-188, është e papranueshme sepse gjatë kontrollit jo që nuk ka marrë pjesë i akuzuari S., por as dy dëshmitarët e moshës madhore, por ka marrë pjesë vetëm djali i të akuzuarit, i cili ka statusin e dëshmitarit të privilegjuar. Andaj, kjo bie ndesh me nenin 108.2 të KPP-së, për shkak të mungesës së dëshmitarit të dytë. Po ashtu, gjatë bastisjes ka munguar edhe avokati i të akuzuarit J. Q., i cili fare nuk ka qenë i pranishëm, por e ka nënshkruar procesverbalin në polici. Po ashtu, as dëshmitarja Z. H., që ka nënshkruar nuk ka qenë e pranishme gjatë kontrollit, por ka ardhur pas përfundimit të tij dhe ka nënshkruar kinse ka qenë prezentë. Më tutje, mbrojtja pretendon se administrimi i deklaratës së dëshmitarit F. Z. i datës 09.09.2019 dhe 23.09.2019, është i kundërligjshëm sepse bie ndesh me nenin 119.2 të KPP-së. Po ashtu, edhe raporti i ekspertimit të AKF me numër AKF/2020-0463/2020-416 i datës 18.05.2020, është i kundërligjshëm sepse bie ndesh me nenin 288.2 të KPP-së.

Sipas ankesës së mbrojtjes, edhe aktvendimi për confirmimin e aktakuzës i datës 04.06.2021, është i kundërligjshëm, sepse është marrë dhe nënshkruar nga KTGJ Mentor Bajraktari, i cili nuk kishte marrë pjesë në shqyrtimin fillestar dhe të dytë të mbajtur me datë 04.11.2020, i cili ishte

kryesuar nga KTGJ i asokohe Arben Hoti, çka bën që aktvendimi të jetë i përfshirë me shkelje esenciale nga neni 384.1 nën par.1.1 të KPP-së. Më tutje, mbrojtja pretendon se është shkelur edhe neni 96 i KPP-së, sepse i akuzuari nuk është njoftuar për masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit kundër tij, po ashtu janë shkelur nenet 3.2, 7, 8.2 dhe 9.1 të KPP-së. Është, cenuar parimi i barazisë së armëve me rastin e refuzimit të propozimeve të mbrojtjes së të akuzuarit S.. Gjithashtu, është shkelur e drejta për konsultim me mbrojtësin para dhe gjatë marrjes në pyetje, është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, nuk është vlerësuar mbrojtja e tij, është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit procedural.

Në anën tjetër, mbrojtja pretendon se edhe gjendja faktike është vërtetuar gabimisht, e përshkruar në pikat I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit. Gjykata, gabimisht ka vërtetuar se i akuzuari S. ka qenë në dijeni mbi arsyen e takimit me dëshmitarin F. Z. me datë 19.09.2019, se ishte dakorduar më herët me dëshmitarin, që të merrte aktgjykim të favorshëm për vëllain e të akuzuarit, se ka kërkuar rryshfet, se ka marrë aktgjykim të favorshëm për të akuzuarin M. Z. dhe se kundërligjshëm ka poseduar revolen e tipit "Zaza Mini". Po ashtu, gjykata ka dështuar që të vërtetojë në mënyrë të plotë faktet, sikurse motivi i dëshmitarit F. Z. për të denoncuar rryshëm të akuzuarin S., trillimin dhe kamuflimin e fakteve dhe rrethanave të paraqitura gjatë bisedës në automjet, i akuzuari nuk ka kërkuar para rryshfet në emër të shqiptimit të një dënimi më të butë për vëllain e dëshmitarit, sanksioni penal i shqiptuar me aktgjykimin kundër të pandehurit M. Z., vëllai i dëshmitarit F. Z., nuk është apeluar nga Prokuroria dhe është konform praktikës gjyqësore në raste të ngjashme, revolja e tipit "Zaza Mini", i përket vëllait të akuzuarit S., nxitja e dëshmitarit F. Z. nga policia me rastin e simulimit të veprës penale. Më tutje, mbrojtja thekson se janë trilluar dhe kamufluar faktet dhe rrethanat e paraqitura gjatë bisedës në automjet, meqenëse gjatë shqyrtimit është vërtetuar se pas drekës, gjatë qëndrimit në automjet, në momentin e dhënies së zarfit me para, dëshmitari F. Z. ka trilluar dhe kamufluar faktet dhe rrethanat e paraqitura gjatë bisedës së përgjuar, në mënyrë që i akuzuari S. vërtet të kujtonte se dëshmitari kishte folur me gjyqtarin S. B.2 dhe se bëhej fjalë për dhuratë pa ndonjë qëllim të përcaktuar. Më tutje, mbrojtja pretendon se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit në kuptim të nenit 385.1 nën par.1.1 të KPP-së, sepse veprimet e tij nuk përbëjnë figurën e veprave penale, për të cilat është shpallur fajtor. Aktgjykimi penal i datës 15.02.2016, përbënte një realitet procedural të paprekshëm dhe të pandryshueshëm për të akuzuarin M. Z., përkatësisht çështje tashmë të gjykuar për të, e cila nuk mund të ndryshohej në dëm të tij, çka vërteton se në kohën e dhënies së mjeteve në lartësi prej 2,000 euro, nuk ekzistonte asnjë mundësi objektive e vetme për të vepruar në pajtim me detyrën zyrtare. Mbrojtja, i referohet udhëzuesit të veçantë të

Gjykatës Supreme mbi korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare publikuar në muajin qershor 2021. Së fundmi, mbrojtja thekson se edhe sanksioni penal është i kundërligjshëm, meqenëse mund t'i shqiptohet vetëm personit i cili ka kryer vepër penale sipas kushteve të parapara me kodin penal dhe ligjet tjera të Kosovës, në bazë të cilave janë paraparë veprat penale, sipas procedurës së zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme para gjykatës kompetente. Argumentet e shtjelluara në ankesë, vërtetojnë se procedura penale që i ka paraprirë marrjes së aktgjykimit nuk është zhvilluar sipas kërkesave procedurale dhe materiale të imponuara nga legjislacioni, ndaj edhe sanksioni penal nuk mund të shqiptohet në të tilla rrethana. Gjykata, ka nënvlerësuar dhe nuk ka vlerësuar rrethanat posaçërisht lehtësuese që karakterizojnë personalitetin e të akuzuarit, se ka vepruar nën provokim të dëshmitarit F. Z., shkalla e ulët e dashjes, koha e kaluar nga pakti korruptiv prej të paktën 10 vjetësh, nuk ka precedent penal, se 30 vjet i ka shërbyer gjyqësorit, se tashmë është pension, gjendja e rëndë shëndetësore dhe gjendja e varfër ekonomike dhe fakti se është mbajtës i familjes. Për këto arsye, mbrojtja ka propozuar si më lartë.

Përgjigja në ankesën e mbrojtjes, e paraqitur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

Në përgjigjen në ankesë, prokuroria konsideron se ankesa e avokatit mbrojtës, është e pabazuar, e mbështetur në spekulime dhe si e tillë duhet refuzuar. Prokuroria, edhe në fjalën përfundimtare ka dhënë të gjitha argumentet bazuar në faktet e çështjes të vërtetuara gjatë gjykimit, dhe në dispozitat ligjore relevante, të cilat ofrojnë bazë të mjaftueshme për të vërtetuar se i akuzuari është fajtor. Mbrojtja, nuk ka ofruar asnjë bazë ligjore apo argument se aktakuza ishte ndryshuar në seancën e datës 24.04.2023. Lidhur, me pretendimin se nuk ka aktvendim për fillim të hetimeve, sipas prokurorisë nuk qëndron, meqë prokuroria ka zhvilluar hetimet, edhe pse i pandehuri S. fillimisht ishte dyshuar për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, më tutje prokuroria kishte ardhur në përfundim se në veprimet e tij përmbushen elementet e veprës penale të marrjes së ryshfetit. Më tutje, sipas prokurorisë, aktgjykimi është i qartë, nuk përmban kundërthënie, janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike dhe është bërë analiza dhe vlerësimi i provave. Janë dhënë arsye si në aktakuzë, ashtu edhe në aktgjykim, me të cilat është vërtetuar situata faktike sikur në dispozitivin I të aktgjykimit. Prokuroria, vlerëson se gjatë hetimeve, por as gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk ishte kontestuese se kush ishte personi i quajtur “D.”, të cilit i referohet dëshmitari Z., si dhe i akuzuari B.. Më tutje, lidhur me pretendimin se aktgjykimi është mbështetur në prova të papranueshme, nuk qëndron meqë nuk ka pasur asnjë shkelje të dispozitave ligjore në marrjen dhe administrimin e këtyre provave. Nuk kemi të bëjmë me “nxitje”, siç e quan mbrojtja e të akuzuarit për të kryer veprën penale. Mbrojtja ka

keqinterpretuar jurisprudencën e GJEDNJ në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së. Prokuroria, nuk vlerëson se kemi të bëjmë me parashkrim relativ, meqë i akuzuari është shpallur fajtor për veprimet e kryera në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës dhe aktgjykimit. Lidhur me pretendimin e mbrojtjes, se prokuroria ia ka mohuar të akuzuarit, të drejtën për konsultim me mbrojtësin nuk qëndron, meqë të akuzuarit gjithmonë i është bërë me dije e drejta e tij për qasje në mbrojtje dhe kjo argumentohet nga dosja e lëndës, konkretisht procesverbali mbi marrjen e deklaratës nga i pandehuri me datë 14.10.2019. Po ashtu, prokuroria konsideron se gjykata ka dhënë arsye të bazuara ligjore dhe faktike kur kishte vendosur që të refuzonte propozimet e mbrojtjes për dëgjimin e dëshmitarëve S. B.2, V. D. – H., S. B.1, M. M. dhe V. K., si dhe dëgjimin e serishëm të V. Sh. dhe F. Z., për të cilët dëshmitarë, prokuroria kishte konsideruar se propozimet e mbrojtjes duhej të refuzoheshin. Andaj, bazuar në të gjitha ato që u thanë në përgjigje, prokuroria ka propozuar që ankesa e mbrojtjes të refuzohet.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit lidhur me pretendimet ankimore të mbrojtjes për sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 paragrafi 2 e duke ekzaminuar aktgjykimin edhe lidhur me shkeljet që Gjykata e Apelit detyrohet që ti shqyrtoj sipas detyrës zyrtare, gjen se ky aktgjykim nuk është i përfshirë me shkelje esenciale, qofshin ato të pretenduara nga mbrojtja apo ato që kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, të cilat si të tilla kur konstatohet kushtëzojnë anulimin e aktgjykimit.

Fillimisht kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë nuk ka cenuar ndonjë dispozitë që ndërlidhen me kategorinë e shkeljeve nga neni 384 paragrafi 1, çka rezulton se aktgjykimin është trajtuar nga ana e gjykatës kompetente, nuk rezulton ndonjë rrethanë që detyronte përjashtimin e gjyqtarëve, se trupi gjykues ka qenë në përbërje të rregullt gjyqësore, se është respektuar e drejta në gjuhë, se shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në prezencën e palëve që duhet të prezantojnë, se akuza e prokurorit ekzistonte se aktgjykimin e ka marr gjykata që ka kompetencë lëndore, se nuk bëhet fjalë për cenimin e dispozitës nga neni 395 pasi që nuk ekzistonte shkak i tillë, dhe se aktgjykimin rezulton me arsye për faktet vendimtare nga të cilat varet zbatimi i dispozitave penale lidhur me faktet që ishin objekt shqyrtimi gjyqësor. Rrjedhimisht për këto shkaqe, kolegji gjen se aktgjykimin nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale nga neni 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 – 1.10.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtësit për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, për të cilat mbrojtja pretendon se janë shkelur paragrafët, 2.1, 2.2, 2.6 dhe 2.7, kolegji i Gjykatës së Apelit me rastin e anulimit të pretendimeve që mbrojtja thekson se shkeljet e tilla kanë ndikuar në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm, kolegji këto pretendime i gjen të pabazuara.

Fillimisht, kolegji vlerëson se aktgjykimi në dispozitivin e tij ka të përshkruara faktet konkrete të cilat shpërfaqin elementet e veprave penale për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor. Rrjedhimisht aktgjykimi si i tillë në dispozitiv është konkret, i qartë dhe nuk ka kundërthënie me veten e tij, nuk vihet në dyshim mungesa e ndonjë fakti që përbën element të figurës së veprës penale për të pamundësuar nënshtrimin e kësaj gjendje faktike në kuadër të normave penalo juridike.

Lidhur me faktet që përshkruhen në aktgjykim, kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye për sa i përket fakteve, e njëkohësisht edhe për sa i përket provave me të cilat gjykata e shkallës së parë i ka administruar ne shqyrtimin gjyqësor dhe ka vërtetuar faktet e tilla, e njëkohësisht rezultojnë të arsyetuar si, besueshmëria e provave dhe vërtetësia e tyre në raporte me gjendjen faktike që ka qenë objekt i shqyrtimin gjyqësor. Në këtë këndvështrim ky kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qëndrueshme dhe të mbështetura në provat e çështjes penale që janë administruar, si dhe të njëjtat arsye janë konkrete dhe të qarta që e bëjnë aktgjykimin që të ketë përmbushur kërkesat ligjore nga neni 369 paragrafi 7 lidhur me pretendimin e mbrojtjes si shkelje nga neni 384 paragrafi 2 nënparagrafi 2.7.

Kolegji i Gjykatës së Apelit lidhur me pretendimet e mbrojtjes se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye për shkak të refuzimit për dëgjimin e dëshmitarëve, si: S. B.2, V. D. H., M. M., S. B.1 dhe V. K., këto pretendime kolegji i Gjykatës së Apelit nuk i gjen të bazuara, duke qenë se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye se përse ka refuzuar propozimet e tilla të mbrojtjes.

Ky kolegji nuk pajtohet me arsyet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me shkakun ligjor kur ka refuzuar propozimin e mbrojtësit të pandehurit për dëgjimin në cilësinë e dëshmitarit S. B. – kjo për shkak se nga aktgjykimi rezulton se gjykata këtë propozim e ka refuzuar për shkak se i njëjti ka qenë duke u hetuar për vepër penale dhe rrjedhimisht është i bashkëpandehur. Gjykata e Apelit nuk përkrah këtë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë pasi që rezulton se ndaj S. B. janë pushuar hetimet, dhe në momentin e pushimit të hetimeve nuk bëhet palë për ekzistimin e

kushteve ligjore nga neni 119 paragrafi 5, duke qenë se subjekti ndaj te cilit janë pushuar hetimet nuk konsiderohet si i pandehur, e rrjedhimisht mund të dëgjohet si dëshmitar.

Megjithatë kolegji i Gjykatës së Apelit e gjen të arsyeshëm refuzimin e mbrojtjes duke qenë se gjykata është e detyruar që procesin gjyqësor ta zhvilloj efektivisht dhe nga tërësia e fakteve të çështjes penale e provave që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor në raport me arsyen e dhënë në propozimin e mbrojtjes, për këtë kolegji dëgjimi i dëshmitarit nuk rezulton se është i nevojshëm për ndriçimin e fakteve, duke qenë se faktet në tërësinë e tyre janë të kushtëzuara për të zbatuar normën penale rezultojnë se janë ndriçuar. Andaj përkundër se kolegji nuk e akcepton shkakun e refuzimit nga gjykata e shkallës së parë, vendimi për refuzim të këtij propozimi është i drejtë dhe nuk cenon asnjë të drejtë të mbrojtjes, gjegjësisht nuk vë në mëdyshje asnjë rrethanë faktike mos dëgjimi i këtij dëshmitari.

Poashtu lidhur me pretendimin e mbrojtjes për shkelje se gjykata ka refuzuar propozimin për dëgjimin në cilësi të dëshmitares V. H., kolegji këtë pretendim të mbrojtjes nuk e gjen të bazuar, duke qenë se gjykata ka dhënë arsye, por edhe ky kolegji vlerëson se dëgjimi i kësaj dëshmitareje nuk ndihmon fare në ndriçim të rrethanave faktike, duke qenë se e njëjta nuk ka qenë fare e përfshirë në veprimet e të pandehurit, e madje as nuk ndërlidhet me veprimet e të pandehurit për veprën penale që është shpallur fajtor. Fakti se kjo dëshmitare ka qenë prokurore kur është propozuar një masë, në asnjë rrethanë nuk e bënë të arsyeshme dëgjimin e saj në cilësinë e dëshmitares, për fakte që janë zhvilluar krejt më vonë e që nuk ka qenë fare e përfshirë në ato veprime të të pandehurit. Ndërsa kolegji i gjen të bazuara dhe të arsyeshme refuzimet edhe për sa i përket dëshmitarëve të tjerë që mbrojtja ka propozuar duke qenë se nuk kanë pasur ndonjë rëndësi për të vërtetuar faktet e çështjes dhe se faktet e çështjes nuk kanë mbetur pa u vërtetuar mbi bazën e provave që janë administruar.

Lidhur me pretendimin e mbrojtjes se gjykata nuk ka aprovuar propozimin për dëgjimin e dëshmitarit S. B.1 B., kolegji ka parasysh se ky dëshmitar nuk ka të bëjë me rrethanat konkrete të ngjarjes në ditën kritike, përveç një aspekti që është pohuar nga dëshmitarja, e cila ka deklaruar se vëllai i të pandehuri ka lënë armën në shtëpinë e tyre pasi që ai ka shkuar për Rozhaj, prandaj duke mos qenë i përfshirë në rrethanat të rastit konkret, kolegji në vijim të pretendimit për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike do të jap arsye lidhur me provueshmërinë e fakteve që mbrojtja e ndërlidhë propozimin me këtë dëshmitar, për sa i përket veprës penale të Mbajtjes në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve, prandaj për këto arsye

kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkelje esenciale të pretenduara nga mbrojtja siç theksohet nga neni 384 paragrafi 2 nënparagrafi 2.7 lidhur me nenin 369 paragrafi 7 i KPP-së.

Gjykata e Apelit nuk e gjen të bazuar pretendimin e mbrojtjes se aktgjykimi është përfshirë me shkelje esenciale të procedurës penale, duke pretenduar se është shkelur neni 68 dhe 100 i Kodit të Procedurës Penale, me pretendimin se prokuroria ka zhvilluar hetimet për sa i përket veprës penale të Keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ndërsa akuzën e ka ngritur për veprën penale të Marrjes së ryshfetit. Kolegji vlerëson se fakti se prokuroria ka filluar hetimet për veprën penale të Keqpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar dhe për pasojë në të njëjtën procedurë hetimore ka konkluduar se nga provat që ka mbledhur rezultojnë elemente e figurës së veprës penale të Marrjes së ryshfetit, për të cilën veprë ka ngritur akuzën dhe për të cilën veprë edhe është gjykuar i pandehuri, nuk rezulton në shkelje veprimi i tillë që përcaktohet në nenin 100. Kjo për faktin se bëhet fjalë për rrethana që ishin në nivel të dyshimit kur zhvillohet hetimi për veprën penale që kishte filluar hetimi dhe rrjedhimisht, hetimi duhet të shërbej për tri qëllime thelbësore; për të vërtetuar saktësisht faktet që konstatojnë kryerjen e veprës penale, për të siguruar prova lidhur me faktet që rezultojnë se ka dyshim se vepra penale është kryer, dhe për të vërtetuar se subjekti aktiv i veprës penale është kryerësi konkret. Në këtë kuptim edhe prokuroria kur ka filluar hetimet ka pasur për bazë faktet që kanë rezultuar me dyshim për veprën penale të Keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe me sigurimin e provave ka konkluduar se plotësohen elementet e veprës penale të Marrjes së ryshfetit. Ndërsa, në raport me subjektin aktiv të veprës penale bëhet fjalë për të njëjtin të pandehur. Ndjekja e logjikës së tillë që mbrojtja e pretendon se në çdo situatë kur të konkludimet se kemi të bëjmë me një veprë tjetër që prokuroria ka konkluduar në akuzë, duhet të nxjerrët aktvendim për zgjerim apo për fillim të hetimeve, jo vetëm që cenon në thelb garancinë procedurale, por njëkohësisht cenon edhe parimet e procedurës penale të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës penale. Prandaj kolegji gjen se përderisa objekt i çështjes së hetimeve kanë qenë faktet dhe i pandehuri i njëjti, dhe me sigurimin e provave për ato fakte rezultojnë elementet e figurës tjetër të veprës penale, nuk cenon në asnjë rrethanë dispozitat e nenit 100. Rrjedhimisht pretendimi i tillë nuk përbën moszbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale për ku kategorizuar si shkelje nga neni 384 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 i KPP-së, siç pretendon mbrojtja.

Gjykata nuk e gjen të bazuar pretendimin e mbrojtjes lidhur me atë që ajo thekson në ankesë “kamuflimin e dhënies së arsyeve”. Që në fillim ky kolegj rikujton se në radhë të parë shprehja e tillë e mbrojtjes është e papranueshme në kuptim të dhënies së pretendimeve ankimore, duke

qenë se gjykata ka detyrim që të jap arsye për faktet që ka vërtetuar, e që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Fakti se mbrojtja nuk pajtohet me arsyet e dhëna nga ana e gjykatës së shkallës së parë, në asnjë rrethanë nuk shpërfaq aktgjykimi “kamufli” siç mbrojtja pretendon, duke qenë se kamufli nënkupton fshehje apo maskim, e duke pasur për bazë detyrimin që ka gjykata me rastin e dhënies së arsyeve për faktet që ka vërtetuar dhe ato që nuk ka vërtetuar ky kolegji, nuk vije në konkluzionin se arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë janë në kundërshtim me shkresat e lëndës, gjegjësisht me provat që ka administruar në shqyrtimin gjyqësor. Po ashtu kolegji nuk e pranon si të bazuar pretendimin e mbrojtjes se gjykata e shkallës së parë ka kamufliuar në arsyetim të aktgjyqimit çështjen e parashkrimit, duke qenë se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet lidhur me tërësinë e fakteve që kanë qenë objekt shqyrtimi. Megjithatë ky kolegji më në detaje lidhur me pretendimet e mbrojtjes për çështjen e parashkrimit do ti jap kur të paraqiten arsyet për pretendimin e shkeljes së ligjit penal.

Kolegji i Gjykatës së Apelit ka parasysh pretendimet e mbrojtjes se të pandehurit që thekson se i është cenuar e drejta për konsultim me mbrojtës, me rastin e marrjes në pyetje në prokurori, duke theksuar se prokurori nuk ka lejuar që të konsultohet me mbrojtësin për pyetjen e parashtruar.

Gjykata e Apelit ka parasysh një pretendim të tillë të mbrojtjes dhe ky kolegji këtë pretendim e trajton në dy premisa bazë: a) si e drejtë e të pandehurit në procedurë, e cila e drejtë i takon në çdo fazë të procedurës, ku kjo e drejtë mvësh në vetvete mundësinë që i pandehuri me rastin e marrjes në pyetje të jap sqarime për dyshimet që i mvishen, gjithnjë kur ai pranon që të deklarohet, dhe b) e drejta për tu konsultuar me mbrojtësin përbën një nga të drejtat që duhet të ketë interpretimin më ekstensiv në dobi të pandehurit.

Dispozita ligjore ka përcaktuar në mënyrë të qartë se të pandehurit gjatë marrjes në pyetje në procedurën penale i takon e drejta për tu konsultuar me mbrojtës, çka nënkupton se në çdo fazë të procedurës kur ai merret në pyetje duhet ti takoj kjo e drejtë e të pandehurit. Në këtë kuptim shkak i mundësisë së kësaj të drejte që i takon të pandehurit ka të bëjë pikërisht me dy të drejtat bazë; a) Mundësia e të pandehurit që përmes marrjes në pyetje ai të jap sqarime për dyshimet që i ngarkohen në këtë fazë të procedurës kur merret në pyetje, dhe b). që me rastin e deklarimit të tij të mos inkriminoj veten e tij.

Po ashtu se kjo e drejtë duhet interpretuar në mënyrën më ekstensive të mundshme për të pandehurin, rezulton nga fakti se bëhet fjalë për dhënien e mbrojtjes efektive dhe profesionale nga ana e mbrojtësit të tij.

Megjithatë, mbështetur në dy premisat bazë, kolegji i Gjykatës së Apelit nuk gjen se me rastin e marrjes në pyetje në fazën e hetimeve nga ana e prokurorit, të jetë cenuar e drejta e të pandehurit për tu konsultuar me mbrojtësin.

Kolegji rikujton se e drejta e të pandehurit rezulton se është përmbushur ligjërisht, kjo përderisa mbrojtja ka qenë prezentë me rastin e marrjes në pyetje. Nga kjo rezulton se është respektuar edhe mundësia e konsultimit me mbrojtjen, çka nënkupton se mbrojtja ka pasur tërë të drejtën për të dhënë këshillat me rastin e konsultimit. Megjithatë, thelbi i çështjes këtu për Gjykatën e Apelit, duke qenë se bëhet fjalë për të drejtën e të pandehurit, duhet të vlerësohet se çka në të vërtetë përbën konsultim i të pandehurit me mbrojtësin me rastin e marrjes në pyetje.

Kolegji rikujton se nuk mund të bëhet fjalë për të drejtën e të pandehurit për tu konsultuar me mbrojtjen kur parashtrihen pyetjet në procedurën penale dhe të ndërpritet rrjedha e procedimit për të konsultuar me mbrojtësin, nga se përkundër faktit se i pandehuri gëzon prezumimin e pafajësisë, ai kur pranon që të deklarohet rrjedhë edhe e drejta e organit që bën marrjen në pyetje për të parashtruar pyetjet ndaj të pandehurit.

Prandaj e drejta e të pandehurit për konsultim me mbrojtjen nuk përfshin të drejtë të tillë të indikacionit për përmbajtjen e përgjigjes, por përfshin të drejtë të tillë për të mos inkriminuar veten dhe për të dhënë sqarimet kur ai dëshiron që të jap sqarime në raport me pyetjet që parashtrihen. Në këtë kontekst, e drejta e konsultimit kur ballafaqohet me ndonjë pyetje konkrete i pandehuri me rastin e marrjes në pyetje, dhe kur mbrojtja profesionale vëren se në çfarëdo rrethanë përgjigja do ta vinte në pozitë të tillë të pandehurin që nuk do të sqaronte faktet apo që do të mund të inkriminonte veten, për dyshimin ndaj të cilit i kumtohet se ekziston, mbrojtja me rastin e konsultimit mund ta këshilloj që ka të drejtën e mos dhënies së përgjigjeve, gjë që nga procesverbali nuk rezulton se në këtë kuptim të jetë cenuar e drejta e të pandehurit që të marrë këshillën lidhur me pyetjet e parashtruara.

Gjykata e Apelit nuk akcepton pretendimin e mbrojtjes siç parashtrohet në ankesë, se mbrojtja ka të drejtë për tu konsultuar me të mbrojturin e tij në çdo pyetje para se të jap përgjigje. Kjo pasi që pretendimi i tillë nënkupton shmangie të tërësishme të qëllimit të normës që ka përcaktuar të drejtat e të pandehurit në procedurën penale me rastin e marrjes në pyetje, duke qenë se siç u

theksua, dy janë shkaqet thelbësore që e bëjnë të drejtën e të pandehurit për konsultim me mbrojtjen që të jetësohet në procedurën penale, e që u theksua se këto shkaqe janë: të jap sqarime lidhur me dyshimet që i komunikohen për veprën penale, dhe të mos inkriminoj veten me rastin e dhënies së përgjigjeve. Prandaj, konsultimi i mbrojtjes gjithnjë për këtë gjykatë duhet të ketë vetëm këto dy qëllime dhe në asnjë rrethanë nuk nënkupton çfarëdo aspekti të përmbajtjes së përgjigjes, se si i pandehuri të jap përgjigjet në raport me pyetjet që parashtrihen ndaj tij.

Lidhur me pretendimin e mbrojtjes për shkelje të dispozitave të procedurës penale, për shkak se nuk është kthyer telefoni i të pandehurit, që mbrojtja thekson se nuk është propozuar që i njëjti të konfiskohet dhe i njëjti nuk është kthyer. Kolegji i Gjykatës së Apelit këtë pretendim nuk e gjen të bazuar për të konkluduar se aktgjykimi është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Dispozita nga neni 113 ka përcaktuar saktësisht se sendet apo provat, që nuk kanë bazë për tu konfiskuar apo rastin e pushimit të procedurës penale duhet ti kthehen pronarit. Rrjedhimisht, siç rezulton nga aktgjykimi, telefoni nuk ka qenë i propozuar si send për tu konfiskuar, çka nënkupton se prokuroria nuk e ka propozuar konfiskimin e tillë, andaj është detyrim i prokurorisë për t'ia kthyer pronarit, gjegjësisht të pandehurit telefonin. Mirëpo fakti se gjykata nuk ka vendosur për kthimin e tillë nuk e bën aktgjykimin me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke qenë se telefoni ishte marrë nga ana e prokurorisë dhe me rastin e ngritjes së akuzës, nuk ka qenë objekt i propozimeve në akuzë për konfiskim. Andaj, që në momentin e ngritjes së akuzës, kur nuk është propozuar që të konfiskohet prokuroria duhet të ia kthej të pandehurit telefonin, qoftë sipas nenit 273 të ish KPP-së, që ishte në fuqi në kohën e ngritjes së akuzës, apo qoftë sipas nenit 113 të KPP-së që është në fuqi. Ndërsa pretendimi i mbrojtjes për ekzaminimin e telefonit të pandehurit që është refuzuar, kolegji i Gjykatës së Apelit këtë pretendim nuk e gjen të bazuar, duke qenë se nuk kanë mbetur në mëdyshje faktet që kanë qenë si objekt i shqyrtimit në procedurën gjyqësore. Për të qenë e nevojshme një ekzaminim i tillë, dhe se pretendimi i mbrojtjes se do të ishte zbuluar qëllimi i dëshmitarit F. për ta vënë në kurth të pandehurin, ky kolegji nuk i gjen të bazuara, duke qenë se çështja e zbatimit të masës së simulimit është mbuluar me provat video dhe audio, që kanë mundësuar zbatimin e masës së simulimit që është përdorur nga ana e prokurorisë përmes policisë, e që e ka vënë në zbatim personi nën mbikëqyrjen e policisë, gjegjësisht dëshmitari F. Z., e që më në detaje gjykata do të jap arsyet lidhur me çështjen e vënies në kurth, kur të arsyetoj pretendimet për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar pretendimin e mbrojtjes së të pandehurit, për sa i përket deklaramit të dëshmitarit F. Z., dhe sa i përket veprimeve të simulimit të veprës penale të Marrjes së rryshfetit, që mbrojtja pretendon se dëshmitari e ka nxitur të pandehurin në kryerjen e veprës penale, dhe po ashtu lidhur me aspekte e deklaramit të këtij dëshmitari që ka theksuar në shqyrtimin gjyqësor, nuk i gjen të bazuara këto pretendime që mbrojtja i konsideron se si të tilla ato kanë shkaktuar që aktgjykimi të jetë marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Kolegji i Gjykatës së Apelit në këtë pjesë të arsyeve të aktgjykimit nuk jep vlerësim në raport me gjendjen faktike, por vlerëson vetëm aspektin e pretendimeve që ndërliidhen me çështjen e shkeljeve të dispozitave të procedurës penale. Kolegji ka parasysh se gjykata e shkallës së parë kur ka vlerësuar deklaramit e dëshmitarit, të dhëna në polici dhe në prokurori, si dhe deklaramit e dhëna në shqyrtimin gjyqësor, çka nënkupton se nga tërësia e provave ka dhënë edhe vlerësimet lidhur me deklaramit e dëshmitarit F.. Ndërsa, pretendimi i mbrojtjes se gjykata ka vlerësuar deklaramit e dhëna në prokurori që si të tilla janë në kundërshtim me nenin 119 të KPP-së, ky kolegji nuk akcepton një pretendim të tillë. Deklaramit e dhëna nga ana e dëshmitarit nuk mund të shërbejnë si prova në seancën e shqyrtimit gjyqësor kur dëshmitari nuk procedohet ne shqyrtim gjyqësor. Mirëpo, duke qenë se dispozita nga neni 325 deri ne 331 kanë te dëshmitarëve dhe si behet marrja ne pyetje e tyre, dhe se me rastin e marrjes në pyetje deklaramit e dhëna në fazat e mëhershme të procedurës që ka dhënë dëshmitari, pyetjet në shqyrtim gjyqësor mbështeten në ato të dhëna, rrjedhimisht ato deklaramit të dhëna në fazën e hetimeve trajtohen në raport me deklaramin e dhënë në shqyrtim gjyqësor. Arsyeja që dispozita nga neni 119 ka përcaktuar se nuk janë të pranueshme në shqyrtim gjyqësor deklaramit e dhëna në prokurori ka të bëj me parimet e procedurës penale, të parimit të drejtpërdrejtë dhe të mundësisë së kundërshtimit të provave. Rrjedhimisht këtu edhe përmbushet parimi i barazisë së palëve, dhe në momentin kur dëshmitari merret në pyetje ne shqyrtim gjyqësor, edhe deklaramit e dhëna në fazën e mëhershme në procedurën penale nga i njëjti dëshmitar, janë prova të pranueshme dhe hyjnë brenda dispozitës nga neni 361 si prova që gjykata ka për detyrë që ti vlerësoj.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e mbrojtjes se dëshmitari e ka nxitur të pandehurin për marrjen e të hollave, kolegji i Gjykatës së Apelit ka parasysh se nxitja konsiston në veprime të personit që zbaton masën e simulimit që ai të ndërmerr veprimet e tilla për të krijuar nivelin e tillë të veprimit kriminal te personi që i ofrohen mjetet monetare. Më konkretisht, kolegji ka parasysh se nxitja nuk nënkupton një fjalë apo një sjellje, por, nxitja në kuptim të trajtimit të veprimit simulues dhe

për tu konsideruar se veprimi i tillë ishte nxitës duhet të plotësoj të paktën dy kushte: a). që i pandehuri të mos ketë qellim kriminal në raport me veprën që nxitet, kjo nënkupton se qëllimi kriminal si element subjektiv – mens rea duhet të mungoj te i pandehuri dhe b) që ky qellim kriminal të formësohet nga ana e personit që zbaton masën e simulimit, çka do të thotë se me sjelljet dhe veprimet e tija duhet të ndikohet te i pandehuri për ta krijuar qëllimin kriminal duke e joshur në çfarëdo rrethanash për të bindur atë të kryej veprimin kriminal. Në rastin konkret, kolegji nga tërësia e provave e më konkretisht nga incizimet përmes masës së simulimit nuk vije në konkludim se te i pandehuri ka pasur mungesë të qëllimit kriminal, dhe se te ai kanë ndikuar veprimet e dëshmitarit F. për ta konsideruar se e ka bindur për kryerjen e veprimit kriminal. Rrjedhimisht, duke mos pasur veprime të tilla, kolegji vlerëson se masa e simulimit të veprës së Marrjes së ryshfetit, e zbatuar nga dëshmitari nën mbikëqyrjen e policisë, dhe mbështetja e aktgjyqimit në këtë provë nuk përbën shkelje të dispozitave të procedurës penale. Ndërsa pretendimi se është nxitur nga ana e policisë dëshmitari, për këtë kolegji është i paqëndrueshëm duke qenë se ky dëshmitar kishte paraqitur vet rastin në polici, dhe se policia kishte kërkuar bashkëpunim. Fakti se ai ka zbatuar masën e simulimit dhe tani deklaron se ka qenë i nxitur, për këtë kolegji kjo nuk përbën nxitje.

Lidhur me pretendimet e mbrojtjes se dëshmitari është shfrytëzuar nga ana e prokurorisë dhe e policisë për të vënë në kurth të pandehurin, duke i premtuar përfitime deri në atë masë sa edhe nuk është dërguar në vuajtje të dënimit, por është lejuar që të ndërmar veprime në zbatim të masës, kolegji rikujton se Prokuroria nuk është institucioni që vendos lidhur me vuajtjen e dënimeve ndaj personave që dënohen, por dënimet procedohen me vendime të Kryetarëve të gjykatave. Rrjedhimisht në këtë drejtim, nuk mund ti referohen veprimet e tilla të dërgimit në vuajtje prokurorisë, pasi që këtë kompetencë e kanë gjykatat. Përtej këtyre arsyeve, kolegji vlerëson se nuk përbën veprime të ndaluara procedurale, që cilido person që mund të ketë rëndësi në zbatimin efektiv të ndjekjes penale, të merret në cilësi të dëshmitarit, apo edhe në zbatim të masave për simulimin e veprave penale. Duke qenë se veprimet e tilla nuk kufizojnë asnjë të drejtë, qoftë të pandehurit apo te dëshmitarit, dhe se dispozitat e procedurës penale garantojnë të drejta, ndërsa fakti se është përdorur ky dëshmitar në zbatim të masës së simulimit të dhënies së ryshfetit, kjo nuk ka pakësuar asnjë të drejtë procedurale për të pandehurin S. B.. Andaj për këtë kolegji pretendimet e tilla nuk e bëjnë aktgjyqimin të jetë marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Kolegji i Gjykatës së Apelit lidhur me pretendimet e mbrojtjes për vlerësimin e dëshmimeve nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i gjen të pabazuara duke qenë se nga arsyet e dhëna në aktgjykimin e ankimuar rezulton se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete në raport me të gjitha provat që ka administruar në shqyrtimin gjyqësor, e po ashtu ka dhënë vlerësimin në raport me faktet dhe në lidhshmëri e provave në tërësi, andaj kolegji nuk gjen se gjykata e shkallës së parë të këtë mungesë të vlerësimit të provave, siç mbrojtja pretendon se ky vlerësim është bërë në mënyrë të pandërgjegjshme. Kjo për faktin se kur ka vlerësim të pandërgjegjshëm shpërfaqet arbitrariteti i vlerësimit të provave, gjë që në rrethana të rastit konkret rezulton se gjykata ka pasur parasysh detyrimet nga neni 360, dhe se ka vlerësuar provat një nga një dhe në lidhshmëri e tyre me faktet që kanë qenë objekt i çështjes penale.

Lidhur me pretendimin e mbrojtjes se masa e simulimit është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore, për pasojë urdhri i dhënë nga gjykata është në kundërshtim me dispozitat ligjore, ky kolegji i gjen të pabazuara. Kolegji vlerëson se në rrethana të rastit konkret tri kushtet ligjore përmbusheshin kur gjykata ka urdhëruar masën e tillë të simulimit. Në radhë të parë kishte dyshim të bazuar duke qenë se rezulton se prokuroria kishte filluar hetimet dhe se në kërkesën e parashtruar nga ana e prokurorisë, gjykata ka konstatuar se ka dyshim të bazuar për veprën penale. Po ashtu rezulton se masa e tillë ishte e domosdoshme duke qenë se me veprimet tjera hetimore rezultatet e tilla nuk mund të arrihen, prandaj edhe përbën masë specifike të simulimit. Po ashtu masat tjera më të buta të ndërhyrjes së autoriteteve nuk mund të jepnin rezultatin e vërtetësisë së dyshimeve që ekzistojnë në fazën e tillë. Ndërsa, pretendimet e mbrojtjes se e drejta e privatësisë është e drejtë e pacenueshme, kolegji i kishte parasysh por, se edhe dispozita kushtetuese që përcakton të drejtën e privatësisë ka paraparë në paragrafin 3 fshehtësinë e korrespondencës si të drejtë që mund të kufizohet vetëm përkohësisht në bazë të vendimit gjyqësor për ecurinë në mënyrë të domosdoshme të procedurës, çka nënkupton se kjo e drejtë ishte kufizuar përkohësisht dhe se kishte vendim gjyqësor. Po ashtu, vendimi i tillë ishte i domosdoshëm për zbatimin e procedurës penale, prandaj pretendimet e tilla për kolegjin e kësaj gjykate janë të pabazuara.

Lidhur me pretendimin e mbrojtjes se procesverbali mbi kontrollin e banesës dhe raporti i AKF janë prova të papranueshme, duke theksuar se ka marrë pjesë në cilësinë e dëshmitarit djali i të pandehurit S., e që mbrojtja thekson se ai nuk mund të jetë dëshmitar, duke qenë se është dëshmitar i privilegjuar, ky kolegji nuk akcepton një pretendim të tillë. Fillimisht kolegji ka parasysh se dëshmitari që merr pjesë në procedurën e urdhër kontrollit nuk pohon apo mohon

rrethana të fakteve penale, ai thjeshtë është vëzhgues i veprimeve të organeve që zbatojnë kontrollin, pa ndërhyrë në asnjë veprim të tyre. Rrjedhimisht, nuk mund të kategorizohet brenda cilësive të tilla si dëshmitar i privilegjuar, sikurse përcaktohen kur ata marrin pjesë në cilësinë e dëshmitarëve në procedurë penale, të cilët shërbejnë për të vërtetuar faktet e çështjes penale. Këtu dëshmitari në procedurën penale të zbatimit të kontrollit është dëshmitar mbi veprimet e zbatimit që i bëjnë organet shtetërore për të mos lejuar asnjë parregullsi mbi zbatimin e veprimeve ligjore nga këto autoritete. Prandaj kolegji vlerëson se nuk është ndalesë e tillë ligjore që të marrin pjesë në cilësinë e dëshmitarëve edhe anëtarët e familjeve në cilësinë e dëshmitarit në zbatimin e urdhër kontrollit. Prandaj për këtë kolegji veprimet e tilla nuk e bëjnë të papranueshme kontrollimin e banesës, e rrjedhimisht as provat që kanë rezultuar me rastin e kontrollimit, apo ekzaminimet e bëra në raport me ato prova që kanë rezultuar nga kontrollimi. Megjithatë ky kolegji rikujton se dëshmitari i tillë bie në kategorinë e dëshmitarëve të privilegjuar nëse kërkohet që të thirren në procedim gjyqësor, për të vërtetuar rrethana lidhur me zbatimin e kontrollit nëse vihen në mëdyshje veprimet e organeve shtetërore gjatë kontrollimit, gjë që këtu nuk është rasti, duke qenë se mbrojtja nuk konteston faktin se arma e gjetur në banesën e të pandehurit nuk ka qenë në atë banesë, por pretendon se fare personat familjarë nuk mund të shërbejnë si dëshmitarë, e që për këtë pretendim u dhanë arsye si më lartë se dispozitat ligjore nuk përcaktojnë cilësi të tillë të dëshmitarit kur shërben vetëm nga aspekti procedural për të vëzhguar veprimet e organeve shtetërore. Ndërsa dëshmitari i privilegjuar për shkak të raporteve me të pandehurin nuk detyrohet për të dëshmuar, duke qenë se ligjdhënësi nuk ka përcaktuar ligjërisht ndërhyrjen deri në atë masë ndërmjet raporteve familjare për qëllim të zbatimit të procedurës penale ka paraparë edhe dëshmitarët e liruar dhe ata të privilegjuar, çka nënkupton se të dëshmitarët e privilegjuar, ligjdhënësi ruan raportet e të pandehurit me atë dëshmitar për shkak të raporteve të tyre. Ndërsa me rastin e kontrollimit të banesës, dëshmitari nuk ka të bëjë me veprimet apo mosveprimet e të pandehurit, por ka të bëjë me veprimet apo mosveprimet e organeve shtetërore në kuptimin që të mos sajohet asgjë nga organet shtetërore që zbatojnë urdhrin. Po ashtu në kuptimin që me rastin e kontrollit të mos shkaktohen dëmet përtej nevojës që kërkon zbatimin e kontrollit të banesës.

Ndërsa lidhur me pretendimin e mbrojtjes se raporti i AKF është provë e papranueshme, për shkak se është propozuar në shqyrtim gjyqësor dhe është pranuar kjo provë, kolegji i Gjykatës së Apelit këtë pretendim e gjen të pabazuar, duke qenë se Prokuroria kishte urdhëruar ekzaminimin e armës për funksionalitetin e saj me datë 06.12.2019, ndërsa tek ekspertimi rezulton se ishte përfunduar nga Agjensioni me datë 18.05.2020. Prandaj fakti se prokuroria ka

parashtruar akuzën ende pa u përfunduar ekspertimi nuk e bën provën e papranueshme, duke qenë se prokuroria ka urdhëruar ekzaminimin e armës, dhe rrjedhimisht raporti mbi atë urdhëresë rezulton se është nxjerrë me datë 18.05.2020. Përkundër se prokuroria ka ngritur akuzën me datë 05.02.2020, veprimi i tillë nuk është veprim kundërligjor që ta bëj provën të papranueshme duke qene së prokuroria veprimin e kishte ndërmarr brenda periudhës kohore sa zhvillonte hetimet, ndërsa fakti se ka ngritur akuzën, kjo vetëm se mund ta bëj prokuroria që akuzën ta këtë të pambështetur me prova. Duke qenë se pranimi i raportit nuk mund ti referohet veprimeve të prokurorisë, por ka të bëj me procedurat e AKF-së, në asnjë rrethanë për këtë kolegji vonesa e tillë nuk mund të konsiderohet se e bënë të papranueshme provën e tillë.

Andaj, për këto arsye kolegji i Gjykatës së Apelit ka gjetur se pretendimet e mbrojtjes së të pandehurit se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale rezultojnë të pabazuara, dhe se aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje as nga ato që kjo gjykatë detyrohet që ti vlerësoj sipas detyrës zyrtare. Prandaj kolegji nuk e ka gjetur të bazuar pretendimin e mbrojtjes për sa i përket bazës së ankimimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Lidhur me pretendimet e mbrojtjes se gabimisht është vërtetuar gjendja faktike, kolegji këto pretendime i ka vlerësuar dhe analizuar në drejtim të fakteve që përshkruhen në aktgjykim, arsyeve të dhëna nga gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar dhe provave që kanë shërbyer për vërtetimin e këtyre fakteve. Andaj duke i vlerësuar pretendimet ankimore kolegji i gjen të pabazuara pretendimet e mbrojtjes se gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë është vërtetuar gjendja faktike.

Kolegji i Gjykatës së Apelit ka parasysh që për sa i përket pikës I të dispozitivit, faktet si në vijim nuk rezultojnë që të jenë kontestuese dhe atë: **a)** se i pandehuri ishte person zyrtar – ky fakt nuk është kontestuar nga ana e palëve por njëkohësisht rezulton i provuar duke qenë se i pandehuri ishte Gjyqtar pranë Gjykatës Themelore në Pejë në Departamentin për Krime të Rënda; **b)** fakti se i pandehuri në cilësinë e Gjyqtarit kishte proceduar çështjen penale PRKP.nr. ../.... të datës 05.01.2015, kundër të pandehurit M. Z. e që ishte vëllai i dëshmitarit F. Z.. Këto rrethana faktike nuk kontestohen nga palët por njëkohësisht rezultojnë se provohen edhe nga ana e provave materiale, gjegjësisht aktgjykimit që është administruar si prove; **c)** nuk është kontestuese se i pandehuri M. Z. ishte dënuar me aktgjykimin PRKP.nr../.... te datës 05.01.2015, dhe atë për dy vepra penale të Kontrabandimit me migrantë nga neni 138, ku i ishte shqiptuar një dënim me burgim të kushtëzuar në periudhë kohore 3 vite me periudhë verifikimi të kushtit prej 2 viteve, këto rrethana përveç se nuk kontestohen nga palët njëkohësisht si të tilla këto

rezultojnë të provuara nga vet përmbajtja e aktgjykimit PRKP.nr.../.... që është nënshkruar nga vet i pandehuri S. B.; d). Nuk është kontestuese se i pandehuri ishte takuar me dëshmitarin F. Z. me datë 19.09.2019 në Restorant “T.” në Pejë për drekë, pasi që paraprakisht ishin pajtuar që të takoheshin. Këto rrethana përveç se nuk rezultojnë kontestuese, njëkohësisht rezultojnë se provohen nga incizimet me video ku shihen të ulur në restorant i pandehuri S. B. dhe dëshmitari F. Z., por edhe nga masat e përgjimit të telekomunikimit ndërmjet dëshmitarit dhe të pandehurit që pajtohen për tu takuar në restorant, ku edhe ushqehen.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vëren se faktet e mëtejme rezultojnë kontestuese për sa i përket pretendimeve të palëve, konkretisht pretendimeve të mbrojtjes ku edhe parashtron në ankesë pretendimet se faktet e tilla si në vijim janë vërtetuar gabimisht dhe atë: a). se i pandehuri nuk ka qenë në dijeni për arsyet e takimit me dëshmitarin F. Z. me datë 19.09.2019 në restorant “T.” në Pejë; b). se i pandehuri S. B. ishte dakorduar më herët me dëshmitarin F. Z. në kohën e procedimit të çështjes penale që të merrte aktgjykim të favorshëm për vulluan e dëshmitarit M. Z. për dy vepra penale Kontrabandim me migrant; c) se i pandehuri S. B. kishte kërkuar ryshfet për të marr aktgjykim më të favorshëm për të pandehurin M. Z.; d) se i pandehuri S. B. kishte marr aktgjykim më të favorshëm në rastin penal PRKP.nr.../.....

Lidhur me këto pretendime të mbrojtjes, Gjykata e Apelit nuk gjen se gabimisht janë vërtetuar faktet e tilla që mbrojtja i pretendon në raport me pikën I të dispozitivit.

Kolegji ka parasysh se nga provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor vërtetohen përtej çdo dyshimi këto fakte që mbrojtja i pretendon se janë vërtetuar gabimisht.

Në radhë të parë nga video incizimi i zbatimit të masës së simulimit rezulton se dëshmitari F. Z. kur takohet në restorant “T.” në Pejë, e fillon bisedën ku ndër të tjera thekson, “ një dhuratë jua kam pru qysh jemi marr vesh e ti ja jep D., i kam vonuar shumë, i lash në veturë në zarf i kam shti, në zarf i lash mi dokumente, ka 1000 jua kam pru ty një e atij një, ai më ka than 3, e unë e kam lan për pak mangu, prej asaj dite që u takuam i kam ndarë i kam shti në zarf. Me të thanë më vike keq”, dhe pastaj në rrjedhë e sipër të bisedës, dëshmitari e falënderon në raport me punën që i pandehuri si Gjyqtar i kishte ndihmuar vëllait të tij në procedurë. Ndërsa vazhdon biseda tutje ndërmjet dëshmitarit dhe të pandehurit, këto rrethana vërtetojnë përtej çdo dyshimi se i pandehuri ishte në dijeni për takimin dhe shkaku që do të takohej me dëshmitarin F. Z., duke qenë se i pandehuri dëgjoj dëshmitarin që fliste për dhuratë që ia kishte sjellë duke theksuar siç jemi marr vesh, ai i pohoj se i kam shti në zarf dhe se jua kam sjellë nga 1000, ndërsa i pandehuri

në ato rrethana as nuk kundërshtoj dhuratë as nuk kundërshtoj marrëveshjen dhe as nuk kundërshtoj falënderimet e dëshmitarit lidhur me ndihmën për vëllain e dëshmitarit në procedurën gjyqësore ndaj tij. Prandaj nuk rezulton asnjë rrethanë që të jetë vërtetuar gabimisht siç mbrojtja pretendon se i pandehuri nuk kishte qenë në dijeni për shkakun e takimit me dëshmitarin.

Po ashtu, nga video incizimi i zbatimit të masës së simulimit, kur në restorantin “T.” bisedojnë dëshmitari F. dhe i pandehuri S., dëshmitari në mënyrë shumë konkrete e përshkruan fillimisht çështjen e procedurës së vëllait të tij, që ishte proceduar penalisht dhe thekson ndër të tjera se: “ u pat ba nervoz shumë ajo prokurorja që se pate qu në burg ti, por se bane të madhe ti hiq bile, thojsh hajt se i kalon prokurorës, në këtë rast ka pas qenë ai prokurori pa flokë, K., por se di qysh erdh kjo në seancë”, i pandehuri i thekson ka ardhur në zëvendësim, pastaj dëshmitari F. i tregon ngjarjen se vëllai i tij kishte frikë dhe i thotë, “ valla boll u tutke në atë rast”. Përveç këtyre rrethana dhe aktvendimit dhe aktgjykimit për Gjykatën e Apelit i vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë fakti që mbrojtja pretendon se gabimisht është vërtetuar fakti që i pandehuri S. B. ishte dakorduar më herët me dëshmitarin F. Z. në kohën e procedimit të çështjes penale që të merrte aktgjykim të favorshëm për vëlluan e dëshmitarit M. Z. për dy vepra penale Kontrabandim me migrantë. Nga tërësia e rrethanave, siç është video incizimi, detajet e përshkrimit të rastit dhe aktgjykimi, si dhe pranimi i dhuratës dhe mos kundërshtimi në asnjë rrethanë përkundër se e kupton se bëhet fjale për dhuratë – mjete monetare tregojnë dhe vërtetojnë përtej çdo dyshimi se i pandehuri ishte marr vesh që të merrte aktgjykim të favorshëm për vëllain e dëshmitarit, t i cili ngarkohej me dy vepra penale të kontrabandimit, të cilin aktgjykim edhe e kishte marrë.

Po ashtu lidhur me faktin se i pandehuri a kishte kërkuar ryshfet, kolegji rikujton se aktgjykimi nuk e ngarkon të pandehurin që ai ka kërkuar, por e ngarkon me faktin se ai ka pranuar ryshfet, nga provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, më konkretisht nga video incizimi në restorant “T.” në Pejë dhe po ashtu nga video incizimi i situatës kur dëshmitari ia jap zarfet të pandehurit, vërtetohet përtej çdo dyshimi se i pandehuri ka pranuar dhuratën. Ndërsa po ashtu nga deklarata e dëshmitarit F. të dhëna në prokurori dhe në polici dhe nga incizimi i zbatimit të masës së simulimit në restorantin “T.” në Pejë vërtetohet se i pandehuri vihet në dijeni se është dhuratë që e ka sjellë për të dhe për personin e quajtur “D.”, që nga ky video incizim vërtetohet se bëhej fjalë për gjyqtarin S., nga se dëshmitari i thotë atij se ai më ka thënë se “të ka si vëlla dhe jo vetëm kolegë”. Të gjitha këto rrethana vërtetojnë se bëhej fjalë për dijeninë e qartë nga ana e të pandehurit se bëhej fjalë për pranimin e dhuratës. Njëkohësisht ai i pohon se dhuratën ta

kam sjell qysh u morëm vesh dhe i pandehuri nuk mohon se kanë pasur marrëveshje paraprake me të, ndërsa se i pandehuri dhuratën e kishte pranuar për shkak të veprimit brenda kompetencave të tij zyrtare, vërtetohet nga aktvendimi nga aktgjykimi që i pandehuri i kishte nxjerr në procedurën penale kundër vëllait të dëmtuarit F.. Si dhe nga biseda e dëshmitarit F. me të pandehurin në Restorant “T.”, ku e diskutojnë rastin e vëllait të tij, se si ky i ka ndihmuar, se si nuk është pajtuar prokurorja që nuk i ka caktuar paraburgim, se si vëllai i dëshmitarit është frikësuar në procedurë, dhe po ashtu që rezulton se atij i ishte dhënë një dënim i kushtëzuar, të gjitha këto prova vërtetojnë se i pandehuri ishte në dijeni se bëhej fjalë për dhuratën dhe se dhuratë ndërlidhet vetëm me punën e të pandehurit, që kishte ndërmarr vendimet gjyqësore në procedurën penale në raport me vëllain e dëshmitarit F. që procedohej penalisht për dy vepra penale të kontrabandimit.

Lidhur me pretendimin e mbrojtjes se gabimisht është vërtetuar fakti se i pandehuri ka marr aktgjykim të favorshëm në procedurën penale ndaj vëllait të dëshmitarit, e që mbrojtja thekson se ka raste të shumta nga praktika gjyqësore për vendime të tilla dhe dënime të natyrës së njëjtë, kolegji rikujton se pikërisht çështja e dy provave themelore në këtë rast penal, dhe atë diskutimi kur dëshmitari F. e falënderon për procedimin e çështjes penale ndaj vëllait të tij në rastin penal si lidhur me masën për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë, e po ashtu edhe lidhur me aktgjykimin që rezulton se i pandehuri e ka marrë në raport me veprat penale të Kontrabandimit me migrantë ndaj vëllait të dëshmitarit F., dhe fakti se atij i komunikohet se ka sjellur dhuratë siç ishin marr vesh, dhe fakti se i pandehuri i pranon dy zarfe me nga 1000 euro secili zarf, çka vërtetohet nga video incizimi në veturë kur i pandehuri i merr dhe i bënë palë zarfet me mjete monetare dhe i fut në xhepin e brendshëm të setrës së tij, dhe del nga vetura dhe kur arrestohet dhe i kërkohet që ti nxjerr nga xhepi të gjitha gjerat ne prezencë të mbrojtësit dhe ai i nxjerr ku ndër të tjera edhe dy zarfet, në të cilat zarfe pas numërimit të mjeteve monetare rezultojnë saktësisht në secilin zarf nga 1000 euro, dhe ne momentin e largimit nga vetura e dëshmitarit i pandehuri S. i thotë “ tu rrit nera”. Të gjitha këto vërtetojnë se veprimet e të pandehurin ishin veprime të marrjes së ryshfetit për marrjen e një vendimi në favor për vëllain e dëshmitarit në procedurën penale sipas aktgjykimit PRKP.nr. ../....., të cilin aktgjykim e kishte marr në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues që ishte i pandehuri S. B.. Fakti i pranimit të dhuratës e bën veprimin e të pandehurit që ishte veprim brenda kompetencave të tij për qellim të pranimit të dhuratës për ta kryer një veprim brenda kompetencave të tij. Kolegji nuk akcepton argumentin e mbrojtjes se ka raste praktike që janë dhënë dënime të natyrës së njëjtë për veprat e njëjta penale në praktiken gjyqësore, andaj vendimi i marrë nga i pandehuri është në përputhje me

praktiken gjyqësore dhe jo në favor. Ky pretendim nuk është i bazuar nga fakti se pranimi i ryshfetit e bënë që të konstatohet favor i vendimmarrjes nga ana e të pandehurit në raport me vëllain e dëshmitarit, nga se në te kundërtën mungesa e marrjes së ryshfetit do ta bënte vendimin si gjykim brenda pavarësisë që një gjyqtar e ka me rastin e vendosjes, por që duke qenë se vërtetohet marrja e ryshfetit, asnjë argument tjetër nuk konkludimet përveç se favorit që i ishte bërë në vendimmarrje vëllait të dëshmitarit, pavarësisht se ka edhe vendime të tilla në praktikën gjyqësore. Prandaj kjo e bën të konsumuar formën e veprës penale të Marrjes së ryshfetit kur veprimi kryhet brenda kompetencave nga ana e zyrtarit, në rastin konkret nga ana e të pandehurit.

Prandaj Gjykata e Apelit për arsyet që i ka dhënë gjykata e shkallës së parë dhe arsyet e theksuara si më lartë, gjen se aktgjykimi i ankimuar drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike për sa i përket pikës I të dispozitivit dhe se pretendimet e mbrojtjes nuk janë të bazuara.

Lidhur me pretendimet e mbrojtjes për sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për veprën penale të Mbrojtjes në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve, kolegji ka parasysh se pretendimet e mbrojtjes shtrihen në drejtim të faktit se arma është e vëllait të të pandehurit dhe se ai e kishte lënë armën në banesën e të pandehurit, pasi që ka shkuar për në Rozhaj. Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, duke qenë se nga përshkrimi i rrethanave faktike i pandehuri është gjetur fajtor, “ që pa autorizim ka mbajtur ne posedim armën e tipit Zaza Mini”, prandaj pavarësisht faktit se arma është e vëllait të pandehurit, siç mbrojtja thekson në ankesë, kjo nuk e bënë gjendjen faktike të jetë vërtetuar në mënyrë të gabuar apo jo të plotë, duke qenë se rezulton se arma i është gjetur të pandehurit me rastin e bastisjes, dhe se gjykata ka dhënë arsyet e saja lidhur me zbatimin e kontrollit në banesën e të pandehurit si më lartë, dhe po ashtu është vërtetuar se arma është funksionale sipas raportit të AKF-së, dhe se gjykata ka dhënë arsyet edhe lidhur me këtë provë si më lartë. Prandaj fakti se arma është gjetur në posedim, kjo nënkupton se mbi atë armë rezulton se pushteti faktik ishte mbi armën që i pandehuri nuk kishte autorizim sipas ligjit për një pushtet të tillë faktik mbi armën, çka e bën të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Ndërsa lidhur me pretendimet e mbrojtjes se ka qenë një pengesë ligjore për të vazhduar lejen e armës së tillë, pasi që nga Ministria iu është kërkuar që derisa të nxirret legjislacioni dytësor të gjithë duhet ti mbajnë në mënyrën e tillë, për Gjykatën e Apelit një rrethanë e tillë është e parëndësishme në kuptim të përgjegjësisë penale në raport me të pandehurin, duke qenë se edhe nën supozimin se Ministria iu ka kërkuar që armët për vazhdimin e lejes duhet të mbahen në atë mënyrë derisa të nxirret legjislacioni dytësor për vazhdim të lejes. Sërish kjo nuk e përjashton

përgjegjësinë e të pandehurit, duke qenë se ai nuk është gjetur fajtor se ka qenë pronar i armës së paautorizuar, por ka qenë në posedim të armës pa autorizim siç u theksua me sipër që pushtet faktik të asnjë arme nuk mund të ketë një person që nuk ka autorizim për posedimin e armës së tillë.

Prandaj Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore të mbrojtjes se pika II e dispozitivit të aktgjykimit është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë, rezultojnë të pabazuara duke akceptuar arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë për këtë pikë të aktgjykimit dhe arsyet e theksuara si më lart e bëjnë aktgjykimin të drejtë dhe të ligjshëm për pikën II të dispozitivit dhe se drejtë e në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike.

Lidhur me pretendimet e mbrojtësit të pandehurit për shkelje të ligjit penal, që mbrojtja pretendon se nuk janë provuar elementet e veprës penale të Marrjes së ryshfetit, dhe as të veprës penale të Mbajtjes në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve, rrethana këto që ndërlidhen me aspektin e të provuarit, gjykata për këto pretendime nuk i gjen të bazuara duke qenë se ka dhënë arsye lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike në raport me faktet për pikën I dhe II të dispozitivit të akuzës, e të cilat fakte shpërfaqin elementet e figurave të veprave penale për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor, prandaj në këtë drejtim kolegji nuk gjen shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Sa i përket pretendimit të mbrojtjes së të pandehurit që thekson se kemi të bëjmë me shkelje të ligjit penal, duke qenë se kemi rrjedhë të afatit të parashkrimit, e që mbrojtja pretendon se afati i parashkrimit të veprës penale fillon nga dita e kryerjes së veprës penale sipas nenit 107 paragrafi 1, e që theksohet se nga dita kur është kërkuar ryshfeti, në këtë kuptim mbrojtja thekson se pakti korruptiv supozohet se është me datë 28.06.2014, dhe nga kjo datë e deri me datë 19.05.2019, kur është marr aktvendimi për fillimin e hetimeve rezulton se kanë kaluar 5 vite e 3 muaj, që nënkupton se ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale.

Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se këto pretendime janë të pabazuara, duke qenë se në rastin konkret nuk kemi rrjedhje të afatit të parashkrimit as relativ por as absolut të ndjekjes penale për sa i përket veprës penale të Marrjes së ryshfetit.

Kolegji konstaton se në rastin konkret kemi të bëjmë me veprimin e ndërmarrjes së veprimit zyrtar brenda kompetencës nga ana e të pandehurit si person zyrtar, e që i atribuohet nxjerrjes së kundërligjshme të aktgjykimit, PRK.P.nr.../.... të datës 05.01.2016, rrethanë kjo që i atribuohet si fakt në aktakuzë e që është konstatuar në aktgjykim që i pandehuri ka vepruar në nxjerrjen e

këtij aktgjykimi në raport me vëllain e dëshmitarit F.. Rrjedhimisht, sipas rrethanave faktike rezulton se veprimi inkriminues brenda kompetencave që ka ndërmarr i pandehuri rezulton me datë 05.01.2016, ndërsa veprimi përfundimtar i konsumimit të tërësishëm të elementeve të veprës penale rezulton me datë 19.09.2019, kur i pandehuri pranon dhuratën për çka kishin pasur dakordim. Prandaj kolegji vlerëson se duke qenë se veprimi inkriminues sipas fakteve që janë vërtetuar është marrja e aktgjykimit me datë 05.01.2016, por se veprimi përfundimtar inkriminues rezulton me datë 19.09.2019 kur pranon ryshfetin, duke qenë se vepra penale në rastin konkret rezulton se është brenda dy veprimeve kur merr veprim për nxjerrjen e vendimit – aktgjykimit dhe kur pranon ryshfetin, sidoqoftë duke pasur për bazë dispozitën nga neni 9 “Koha e kryerjes së veprës penale”, e cila përcakton se koha e kryerjes së veprës penale është koha kur kryerësi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veproj, pa marrë parasysh se kur është shkaktuar pasoja, e duke pasur për bazë se kjo gjykatë gjen se koha e veprimit të pandehurit S. B. rezulton momenti i marrjes së aktgjykimit më të favorshëm, veprim ky i bërë në pajtim me detyrën e tij zyrtare që kishte pranuar dhuratën, duke llogaritur kohën e marrjes së aktgjykimit nga ana e të pandehurit, që rezulton me datë 05.01.2016 deri në momentin kur kanë filluar hetimet, që rezulton data 10.09.2019, nuk kanë kaluar 5 vite siç pretendon mbrojtja. Ndërsa pretendimi i mbrojtjes që të konsiderohet kohë e kryerjes së veprës penale koha kur është marrë aktvendimi lidhur me masën për sigurinë e prezencës së të pandehurit (aktvendimi në raport me vëllain e dëshmitarit F. Z.), as nuk ka qenë pretendim i akuzës e as nuk është konstatim si fakt në aktgjykim, dhe se i pandehuri ngarkohej për marrjen e aktgjykimit të favorshëm ndaj M. Z. – vëllait të dëshmitarit F. Z., që kishte pranuar ryshfet në shumën prej 2000 euro. Prandaj, pretendimi i mbrojtjes se ka kaluar afati i parashkrimit relativ të ndjekjes penale për kolegjin e Gjykatës së Apelit rezulton i pabazuar për arsyet e theksuara si më lart.

Lidhur me pretendimet ankimore të prokurorisë dhe pretendimet ankimore të mbrojtësit të të pandehurit, për sa i përket vendimit mbi dënimin, kolegji ka gjetur se ankesa e Prokurorisë është e pabazuar ndërsa ankesa e mbrojtjes së të pandehurit është e bazuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit ka parasysh pretendimet ankimore të prokurorisë, që thekson se gjykata nuk ka vlerësuar drejtë rrethanat rënduese në raport me të pandehurin, më konkretisht nuk janë marrë për bazë rrethanat se marrja e ryshfetit nga ana e Gjyqtarit apo Prokurorit është forma më e rëndë e korrupsionit, duke qenë se janë pozita të ndjeshme. Po ashtu theksohet se i pandehuri nuk është pajtuar asnjëherë për veprën penale të kryer, si dhe motivin e kryerjes së veprës penale i ndikuar nga motivi financiar, duke theksuar se dënimi i shqiptuar në kohëzgjatje

prej 2 vite e 6 muaj dhe dënim me gjobë në shumën prej 4000 euro, si i tillë është mjaft i ulët, duke qenë se vepra penale parasheh për një vepër penale që parashihet dënimi me burgim prej 1 deri në 8 vite dhe dënimi me gjobë, ndërsa po ashtu ka shqiptuar dënimin me gjobë në lartësi prej 1000 euro, për veprën penale të Mbjajtjes në pronësi apo kontroll të armëve, vepër kjo që parasheh dënim me gjobë deri në 7500 euro, apo me burgim deri në 5 vite. Për arsyet e theksuara propozohet dënimi më i rëndë sesa ai i shqiptuar për të dy veprat penale.

Ndërsa mbrojtja e të pandehurit lidhur me sanksionin penal thekson se gjykata nuk ka marr për bazë rrethanat lehtësuese në raport me të pandehurin kur ka shqiptuar dënimin për veprat penale që e ka shpallur fajtor dhe atë, konkretisht nuk ka vlerësuar rrethanat e kohës së kaluar nga akti i veprimit të pandehurit, se i pandehuri nuk ka të kaluar penale, gjendja e rëndë shëndetësore e të pandehurit, gjendja ekonomike dhe fakti se është mbajtes i familjes, tashme është në pension. Mbrojtja po ashtu thekson se nuk janë vlerësuar rrethanat lehtësuese si: shkalla e ulët e dashjes së të pandehurit për kryerjen e veprës penale, ka vepruar në provokimin e dëshmitarit F., dhe faktin se ka shërbyer për 30 vite si gjyqtar.

Gjykata e Apelit gjen se në aktgjykimin e ankimuar, më konkretisht në faqe 43 rezulton se si rrethana rënduese gjykata e shkallës së parë ka marr parasysh funksionin e të pandehurit si gjyqtar, se ka qenë i detyruara që të ketë sjellje me integritet të lartë, si në aspektin zyrtar e ashtu edhe atë privat, se përvoja e gjatë e tij si gjyqtar është pritur që të ndaj drejtësinë, që për pasojë me veprimin e tij, jo vetëm që ka humbur imazhin e sistemit gjyqësor, por njëkohësisht edhe humbjen e besimit tek qytetarët. Ndërsa si rrethana lehtësuese janë vlerësuar faktin se i njëjti ka qenë tejet korrekt gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale.

Fillimisht kolegji i Gjykatës së Apelit në raport me pretendimet e prokurorisë, gjen se rrethana se i njëjti ka qenë gjyqtar, është marrë për bazë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e madje është vlerësuar edhe përvoja e tij si gjyqtar, që me veprimin e tillë të kryerjes së veprave penale ka dëmtuar edhe besimin te qytetarët, por edhe imazhin e sistemit gjyqësor. Prandaj ky pretendim rezulton i pabazuar. Po ashtu kolegji nuk akcepton pretendimin e prokurorisë që si rrethanë të merret për bazë motivi financiar, kjo për faktin se te vepra penale e Marrjes së ryshfetit vetvetiu duke pranuar dhuratën, inkorporohet motivi i tillë që ka qellim përfitimin nga veprimi korruptiv. Prandaj vlerësimi i rrethanës së motivit do të bënte vlerësim të dyfishtë të rrethanave rënduese. Po ashtu kolegji i Gjykatës së Apelit nuk akcepton pretendimin e prokurorisë që fakti se i

pandehuri nuk është penduar të vlerësohet si rrethanë rënduese, duke qenë se pendimi apo mospendimi ka të bëjë me qëndrimin e të akuzuarit karshi veprës penale që ngarkohet, e rrjedhimisht i pandehuri në asnjë rrethanë nuk ka pranuar se ka kryer veprën penale, andaj pretendimi i tillë për kolegjin e kësaj gjykate është i pabazuar.

Ndërsa lidhur me pretendimet e mbrojtjes, kolegji i Gjykatës së Apelit i gjen të bazuara vetëm këto pretendime që duhet vlerësuar si rrethana lehtësuese e që nuk janë marrë për bazë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe atë: koha e kaluar nga veprimi në pajtim me detyrën zyrtare për qëllim të marrjes së ryshfetit, që rezulton se nga koha e veprimit kur është nxjerrë aktgjykimi nga ana e të pandehurit si veprim i ndërmarrë në pajtim me detyrën zyrtare që është data 05.01.2014, kanë kaluar 8 vite që nënkupton se është një kohë bukur e gjatë nga veprimi i tillë. Po ashtu koha si rrethanë lehtësuese është dashur të merret për bazë edhe fakti se i pandehuri në momentin e marrjes së aktgjykimit kur është konstatuar se është fajtor, i njëjti tanimë gjendej në një moshë të shtyrë, që rezulton se edhe është pensionuar. Si rrethanë tjetër që ky kolegji e akcepton si pretendim të mbrojtjes është gjendja e rëndë shëndetësore, që nga shkresat e lëndës ka edhe situata që mbrojtja kishte dorëzuar në gjykatë dokumentacion mjekësor në raport me të pandehurin, sa që kishte determinuar edhe shtyrjen e seancave gjyqësore, e që tregon për një gjendje jo të mirë shëndetësore, si dhe faktin se është mbajtës i familjes, që nënkupton se si mbajtës i familjes ka detyrime të caktuara brenda familjes së tij, dhe fakti se është në pension, që kur merren për bazë të ardhurat që krijon nga pensioni, rezulton se duhet të merret për bazë si rrethanë lehtësuese.

Ndërsa kolegji nuk i pranon pretendimet e mbrojtjes që të vlerësohen si rrethanë lehtësuese: faktin se ka vepruar në provokim të dëshmitarit – pasi që nuk rezulton asnjë lloj provokimi, thjeshtë rezulton pranimi i ryshfetit – mjeteve monetare siç është theksuar më sipër në arsyetim, po ashtu nuk pranohet si rrethanë lehtësuese shkalla e ulët e dashjes, pasi që nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprës penale nuk rezulton shkallë e ulët e dashjes por shkallë e lartë, duke qenë se i njëjti vë kontakt me dëshmitarin, pranon që të takohet, shkojnë për të pirë kafe dhe për tu ushqyer, ku njoftohet se dhurata i ka arritur sipas marrëveshjes, dhe nga aty futet në veturën e dëshmitarit ku edhe i pranon të hollat. Këto rrethana nuk shpërfaqin shkallë të ulët të dashjes, por shkallë të lartë të dashjes, duke qenë se ai kuptonte çdo veprim dhe se ishte i gatshëm që të ndërmerre ato veprime, dhe u pajtua që të shkaktohet pasoja e veprave penale. Po ashtu nuk mund të vlerësohet si rrethanë rënduese fakti se ka shërbyer 30 vite si gjyqtar, kjo për shkak se Gjykata e Apelit këtë rrethanë me të drejtë të përvojës e ka vlerësuar si rrethanë rënduese nga

fakti se pikërisht kjo rrethanë do të duhej ti shërbente të pandehurit që të mos ndërmernte veprim të kryerjes së veprës penale që ka të bëjë me detyrën e tij si gjyqtar.

Andaj nga rrethanat e vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, dhe këto të pranuar si pretendime të drejta të mbrojtjes, nga kolegji i kësaj gjykate është vlerësuar si e bazuar ankesa e mbrojtjes vetëm lidhur me sanksionin penal, që ka të bëjë me dënimin me burgim dhe me dënimin me gjobë, ashtu që kolegji ka ndryshuar aktgjykimin si në pikën 1 të dispozitivit, duke qenë se në dritën e të gjitha këtyre rrethanave lehtësuese dhe atyre rënduese, me dënimin e shqiptuar si në pikën I të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit si në preventivën e posaçme, ashtu edhe në preventivën e përgjithshme, dhe njëkohësisht do të arrihet risocializimi i të pandehurit, e po ashtu dënimi si i tillë shpërfaq edhe gjykimin shoqëror për veprat penale.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

APS.nr.45/2023 me datë 15.12.2023

B.profesional
Gazmend Ramadani

Anëtarët e kolegjit
Burim Ademi

Kryetar i Kolegjit,
Ferit Osmani

Bashkim Hyseni